



Prishtinë, 15 tetor 2018
Kodi i ZRRE: V_1050_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Neni 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Neni 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, Neni 47 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe Neni 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Rregullës për vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe të Tregut (Rregulla për të Hyrat e OST/OT);
- Parimet për përcaktimin e tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (SHST) dhe taksave të kyçjes;
- Vendimin V_1028_2018 për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për OST/OT;
- Metodologjinë për përcaktimin e tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit (SHST);
- Metodologjinë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Sistemit;
- Metodologjinë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Tregut; dhe
- Aplikacionin/Kërkesën e KOSTT SH.A. për aprovimin e tarifave të OST/OT për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, operatorit të sistemit dhe tregut në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, të dorëzuar më datën 04 tetor 2018,

në seancën e mbajtur më 15 tetor 2018 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** - tarifat për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, operatorit të sistemit dhe tregut, për periudhën 01 tetor 2018-31 mars 2019.
- II. Struktura e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, operatorit të sistemit dhe tregut për KOSTT SH.A, do të zbatohet nga data 01 tetor 2018 është dhënë në tabelën e mëposhtme:


GRUPI TARIFOR	ELEMENTI TARIFOR	NJËSIA	TARIFA
Prodhimi i Kyçur në Transmetim	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.933
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.026
Prodhimi i Kyçur në Shpërndarje	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.279
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.026
Operatori i Shpërndarjes	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	1.033
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.029
Furnizimi	Tarifa e SHST 400/220 kV	€/kW	7.580
	Tarifa e SHST 110 kV	€/kW	15.515
	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	1.033
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.029
	Tarifa e Fondit të BRE	€/MWh	0.731

ARSYETIM


- 📌 ZRRE më datë 04 tetor 2018 ka pranuar nga KOSTT SH.A, aplikacionin për tarifatat për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, operatorit të sistemit dhe tregut për OST/OT.
 - 📌 ZRRE për vendosjen e tarifave për OST/OT, ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në faqen zyrtare të saj si në vijim:
 - 📌 Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale Shqyrtimi Periodik për OST/OT, i publikuar me datën 24 gusht 2018; dhe
 - 📌 Raport Përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale OST/OT – Përgjigjet ndaj Komenteve, i publikuar me datën 24 shtator 2018.
 - 📌 Bordi i Rregullatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të zbatohet nga KOSTT SH.A dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. kryesues


Besim Sejfiraj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) dhe
- Arkivit të ZRRE-së.